

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZEMËRTORE E DOKUMENTARISË
NR. 9814
DATE 11.12.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 16349 Regjistri

Tiranë, më 10.12.2024

NJOFTIM ME SHPALLJE

Në Gjykatën Administrative të Apelit është duke u gjykuar në dhomë këshillimi çështja administrative me palë ndërgjyqëse:

PADITËS:

Shoqëria “Bosnalijek, farmaceutska i hemijska industrija, dionicko drustvo” shoqëri e së drejtës Boshnjake, me seli në Jukiceva 53-71 000 Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë (BA) e regjistruar pranë Gjykatës së Sarajevës, me numër 65-02-0055-1.

E PADITUR:

Drejtoria e Përgjithshme të Patentave dhe Markave

PERSON I TRETË:

Shoqëria “FERRERRO” spa, me adresë Piazzale Pietro Ferrero, 1-12051 Alba Cuneo, Itali.

OBJEKTI:

-Apelim kundër vendimit nr. prot 576/8, datë 201.01.2017, të Bordit të Apelimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave.

-Shfuqizimin e Vendimit nr. prot 576/8, datë 20.01.2017, të Bordit të Apelimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, me pasojë detyrimin e DPPM-së, që të pranojë regjistrimin e markës ROYAL KINDER (fjalë dhe figurë) me numër aplikimi AL/T/2015/576 datë 08.09.2015, publikuar në Buletinin e Pronësisë Industriale nr.01/2016 të DPPM.

BAZA LIGJORE:

Neni 7, 11/1, 15/a, 17/a e vijues i ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (ne vijim “Ligji nr.49/2012”); Nenet 31 e vijues, 153 e vijues, Neni 348 i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë; Neni 140 e vijues, 153 (4), neni 156 e vijues i Ligjit nr.9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”: VKM nr.1706, datë 29.12.2008 “Për Miratimin e Rregullores për Regjistrimin e Markave Tregtare dhe të Shërbimet”, i ndryshuar; Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale hyrë në fuqi me datë 4 tetor 1995. Neni 113 e vijues i Kodit të Procedurave Administrative.

Bazuar në nenin 133 të K.Pr.Civile, njoftohet me anë të kësaj shpallje publike, Shoqëria “FERRERRO” spa, se gjatë gjyqimit të çështjes në dhomë këshillimi Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 199 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi të bëjë kalimin procedural të palës së paditur nga Drejtoria e Përgjithshme të Patentave dhe Markave tek Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale.

Një kopje e kësaj shpallje të afishohet në **Gjykatën Administrative të Apelit**, në faqen zyrtare të **Gjykatës Administrative të Apelit, Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale** dhe në **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë**.

GJYQTARE

Altina NASUFI

